

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

EDOL

Sot, më datë 06.08.2021, personalisht:

- **Eduard UKA**, i biri i Ndue-s, i datëlindjes 28.10.1985, shtetas shqiptar, lindur ne Puke dhe banues ne Rr.e Durrësit, Prana Casa Italias, Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare EDOL Sh.p.k.
- **Fiordi KOLECI**, i biri i Zenel-it, i datëlindjes 13.02.1986, shtetas shqiptar, lindur ne Skrapar dhe banues ne L.Hasan Seitaj, Skrapar person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare EDOL Sh.p.k.

Përpilojnë këte akt themelimi të shoqërisë tregtare EDOL **sh.p.k**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojnë Shoqërinë Tregtare EDOL, në formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri EDOL SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit EDOL SH.P.K dhe me emrin tregtar EDOL. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4 Objekti i veprimtarisë


Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Hapje fabrika për skicim, qepje, montim, riparim, prodhim etj për produkte me bazë lëkure, të përfunduara ose pjesë të tyre, për vete apo për llogari të të tretëve.

Trainimi i punonjësve në aktivitetin fason duke zhvilluar kurse trainimi profesioinal.

NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi BLU, Nr.534, Kamëz.



Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mije) Lek dhe zotërohen nga ortakët themelues

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 2.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

NENI 7

Ortakët themelues te Shoqërisë Tregtare “EDOL” Sh.p.k zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Eduard UKA: pjesëmarrja në përqindje 50 %, 1 kuotë, lloji i kontributit në para.
- Fiordi KOLECI: pjesëmarrja në përqindje 50 %, 1 kuotë, lloji i kontributit në para.

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9 Administratorët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit (ose ne te ardhmen administratorët) të cilët zgjidhen për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë eshte ortaku Z. Eduard UKA.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, te cilet i ushtrojnë këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratket mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdurojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12


Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe.

ORTAKET THEMELUES

Eduard UKA

Eduard UKA


Fiordi KOLECI

Fiordi KOLECI
